



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 30 maj 2011
Nr. ref.: VHL112/11

VENDIM PËR HEQJEN NGA LISTA TË KËRKESËS

në

Rastin Nr. KI 11/09

Parashtrues

Tomë Krasniqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 2.1 të Urdhëresës Administrative të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) Nr. 2003/12, dhe nenit 20.1 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, Ligji Nr. 02/L-47

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është Tomë Krasniqi nga Prishtina, Kosovë.

Objekti i çështjes

2. Parashtruesi pohon që imponimi i pagesës mujore prej 3.5 eurove, të inkasuar nga Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejme: KEK) për shërbime të Radiotelevizionit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: RTK), është jokushtetues. Ai pohon që gjendja e tij financiare, si pensionist me të ardhura shumë të kufizuara, bën që imponimi i pagesës të jetë barrë e madhe për të dhe ia shkel të drejtat themelore të garantuara me Kushtetutë. Parashtruesi gjithashtu pohon që imponimi i pagesës përmes

kushteve të një kontrate ndërmjet KEK-ut dhe konsumatorëve të energjisë elektrike ia shkel të drejtat e tij themelore të garantuara me Kushtetutë.

3. Parashtruesi pohon që skema e sajuar sipas Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut në lidhje me kontratën e lidhur ndërmjet KEK-ut dhe RTK-së ia shkel të drejtat e tij kushtetuese. Kjo skemë dhe forma e kontratës trajtohen në vijim.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 32 (4) dhe 56 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 16 mars 2009, parashtruesi e dorëzoi një kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese lidhur me kushtetutshmërinë e zbatimit të nenit 2.1 të Urdhëresës Administrative Nr. 2003/12, lidhur me zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/13 mbi Themelimin e RTK-së.
6. Kryetari e caktoi gjyqtaren Iliriana Islami si Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Ivan Čukalović.
7. Më pas, më 2 shtator 2009, parashtruesi kërkoi masa të përkohshme për ndalimin e zbatimit të pagesës në pritje të vendimit përfundimtar mbi meritat e kërkesës fillestare.
8. Gjykata mbajti një seancë dëgjimore më 6 tetor 2009, në të cilën ishin të pranishëm dhe morën pjesë parashtruesi dhe përfaqësuesit e RTK-së dhe të KEK-ut.
9. Në përputhje me nenin 116(2) të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit dhe nenin 52 në lidhje me nenin 59 të Rregullores së punës, që ishin në zbatim në atë kohë, Gjykata nxori një vendim, më 16 tetor 2009, me të cilin caktohej masa e përkohshme ndaj zbatimit të mëtejshëm të dispozitave të nenit 20.1 të Ligjit për RTK-në deri në vendosjen meritore për këtë kërkesë. Gjykata i rekomandoi Kuvendit të Kosovës që ta rishikojë natyrën e nenit 20.1 të Ligjit për RTK-në dhe praktikat e bazuara në dispozitat e tij.
10. Më 14 qershor 2010, Gjykata e përtëriti masën e përkohshme deri më 1 janar 2011 dhe kërkoi nga Kuvendi i Kosovës që ta informonte Gjykatën me kohë për përparimin lidhur me zbatimin e rekomandimit të mëparshëm të Gjykatës.
11. Gjykata e shqyrtoi më tej këtë çështje më 17 maj 2011.

Faktet

12. Më 2 mars 2006, parashtruesi i shkroi KEK-ut duke kërkuar që të drejtat e tij personale të mos cenoheshin për shkak të gjendjes së tij personale dhe shkeljes së integritetit dhe personalitetit që një pensionist të jetë i detyruar të paguajë 3.5 euro në muaj për RTK-në.
13. Pasi Divizioni i distribuimit, Sektori i shitjes i KEK-ut, nuk u përgjigj në ankesën me shkrim, parashtruesi paraqiti një ankesë më 13 prill 2006 pranë Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve (në tekstin e mëtejme: DMK) të Zyrës së Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme: ZRRE) lidhur me mosveprimin e administratës së KEK-ut.

14. Më 27 prill 2006, DMK i ZRRE-së e hodhi poshtë ankesën. Më 28 prill 2006, i pakënaqur me atë vendim, parashtruesi paraqiti kërkesë për rishqyrtim të vendimit të DMK-së pranë Bordit të ZRRE-së.
15. Më 27 maj 2006, Bordi i ZRRE-së e hodhi poshtë ankesën kundër vendimit të DMK-së, duke thënë që parashtruesi mund t'i përdorte mjetet juridike kundër këtij vendimi pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë.
16. Më 7 korrik 2006, parashtruesi inicioi procedurë pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë duke kërkuar, ndër të tjera, që pagesa prej 3.5 eurove "të shpallej e pavlefshme".
17. Më 22 janar 2007, pasi kishin kaluar më tepër se gjashtë muaj nga dita e parashtrimit të rastit, parashtruesi kërkoi nga Gjykata që "ta thërriste një seancë gjyqësore për këtë çështje".
18. Më 12 qershor 2007, ai kërkoi "thirrje urgjente të seancës gjyqësore". Parashtruesi theksoi që "Gjykata vazhdoi të heshtte, çka praktikisht dhe realisht e pengoi realizimin e të drejtës së parashtruesit për mjete efikase juridike". Gjykata Kushtetuese nuk është njoftuar për ndonjë vendim të nxjerrë nga Gjykata Komunale lidhur me këtë çështje.

Përgjigja e Radiotelevizionit të Kosovës

19. Më 7 shtator 2009, RTK iu përgjigj kërkesës duke thënë në përgjithësi që parapagimi në përputhje me nenin 20 të Ligjit për RTK-në, ishte mënyrë adekuate e financimit për RTK-në, e miratuar nga Kuvendi i Kosovës.
20. RTK ceku me sa vijon:
 - Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin Nr. 02/L-47 për Radiotelevizionin e Kosovës, i cili hyri në fuqi më 20 janar 2006;
 - Sipas këtij ligji, Kuvendi i Kosovës është autoriteti themelues i institucionit publik të RTK-së;
 - RTK ofron shërbim publik në fushën e radios dhe të televizionit, me një kanal televiziv dhe dy kanale të radios, përmes shërbimeve të veta. Programet e saj transmetohen përmes satelitit për diasporën dhe bashkësitë pakicë të Kosovës në shtetet e tjera;
 - Kuvendi i Kosovës është i vetmi institucion i autorizuar për ta përcaktuar shumën që duhet të paguhet nga qytetarët për shërbime të RTK-së. Kjo u bë përmes nenit 20.1 të Ligjit. Të gjithë personat fizikë dhe juridikë në territorin e Kosovës janë të obliguar të paguajnë për shërbime të transmetimit publik të RTK-së;
 - Kontrata për shërbime Nr. 2532/08, e 1 dhjetorit 2008, ndërmjet KEK-ut dhe RTK-së, duhej të skadonte më 1 dhjetor 2009, dhe shërben si bazë për arkëtimin e 3.5 eurove nga KEK-u në emër të RTK-së; dhe
 - RTK konsideroi në përgjigjen e vet se puna e vet, si transmetues publik, ka bazë ligjore. RTK e konsideron Ligjin si bazë juridike për punën e vet në shoqërinë kosovare.
21. Në seancën publike të mbajtur më 6 tetor 2009, RTK ngriti edhe këto çështje:

- Pasi Ligji për RTK-në hyri në fuqi, Urdhëresa e mëparshme Administrative e UNMIK-ut Nr. 2003/12 dhe Rregullorja e mëparshme e UNMIK-ut Nr. 2003/13 nuk vlejné;
- Parashtruesi nuk saktësoi në kërkesën e vet cilat dispozita të Kushtetutës pretendohet të jenë shkelur, apo cili ishte akti konkret i autoritetit publik që e kontestonte;
- Ligji për RTK-në e definon statusin e RTK-së si organ që ofron shërbim publik në fushën e radios dhe të televizionit, dhe që Kuvendi i Kosovës e themeloi RTK-në, dhe që Kuvendi është përgjegjës për ta garantuar autonominë dhe pavarësinë editoriale dhe financiare të RTK-së;
- Që RTK ishte subjekt i monitorimit nga Komisioni i Pavarur për Media dhe që reklamimi në RTK ishte i rregulluar dhe kishte kohë të kufizuar;
- Që RTK nuk ishte “transmetues shtetëror”, por që misioni i saj ishte të ofronte transmetim publik për t’u shërbyer nevojave dhe interesave të publikut dhe duhej të finançohej përmes publikut;
- Që pas rekomandimeve të Këshillit të Evropës për transmetues publikë ai financim duhet të jetë i sigurt dhe transparent për të siguruar pavarësi editoriale dhe autonomi institucionale;
- Që paragrafi 20.9 i Ligjit për RTK-në thotë se *“Familjet që janë përfshirë në listën e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale si kategori të veçanta përfshirë edhe ato që janë nën asistencë sociale do të lirohen nga parapagimi i kësaj shume”*. Prandaj, ai parashtrues nuk i ka shfrytëzuar mjetet juridike që i garantohen me Ligjin për RTK-në;
- Që referencat në kërkesë në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve nuk janë relevante pasi Ligji i miratuar nga Kuvendi ofron bazën për kontratë ndërmjet RTK-së dhe KEK-ut; dhe
- Që dispozitat ligjore që lejojnë arkëtimin e pagesës mujore prej 3.5 eurove nuk e kanë rrezikuar apo nuk kanë shkaktuar dëm të pariparueshëm që e rrezikon interesin publik, përkundrazi, kjo parashihet me financimin afatgjatë të transmetuesit publik në Kosovë.

Përgjigja e Korporatës Energjetike të Kosovës

22. Pala tjetër e interesuar, KEK-u, nuk u përgjigj me shkrim në kërkesën e Gjykatës Kushtetuese, por u paraqit në seancën publike të mbajtur më 6 tetor 2009, dhe ceku çështjet në vijim:

- Arkëtimi i pagesës nga KEK-u në emër të RTK-së ishte bërë për shkak të kontratës së nënshkruar në mes tyre, që ligjërisht ishte autorizuar, dhe KEK-u veproi në përputhje me kontratën për shkak të obligimeve të veta ligjore për ta bërë atë;
- Kontrata për arkëtimin e pagesës mujore duhej të skadonte më 30 nëntor 2009;
- Në shumë rajone të cilat nuk mbuloheshin nga sinjali i RTK-së, KEK-u vazhdoi me arkëtimin e pagesës përkundër kundërshtimeve dhe mospagesës së faturave të rrymës. Që borxhet të cilat arrinin deri në rreth 400 milionë euro ishin të mëdha;

- Disa autoritete fetare, bazuar në rregullat e fesë, nuk paguanin për rrymë dhe që kjo ishte njëra prej disa kundërshtimeve me të cilat KEK-u përballej në terren lidhur me arkëtimin e borxheve për rrymë;
- KEK-u më nuk ishte i interesuar të vepronte si agjent arkëtues për RTK-në pas 30 nëntorit 2009, datës së skadimit të marrëveshjes kontraktuese ndërmjet tyre dhe RTK-së; dhe
- Asnjë shumë nuk ishte marrë nga buxheti i Kosovës për ofrimin e shërbimit për arkëtimin e pagesës mujore.

Ngjarjet që nga caktimi i masave të përkohshme

23. Gjykata caktoi masa të përkohshme me kërkesën e parashtruesit më 16 tetor 2009, me sa vijon:

I. CAKTOHET masa e përkohshme ndaj zbatimit të mëtejshëm të nenit 20.1 të Ligjit mbi Radio Televizionin e Kosovës, deri në vendosjen meritorie të rastit KI 11/09;

II. Kuvendit të Republikës së Kosovës i REKOMANDOHET që ta rishikojë natyrën e nenit 20.1 dhe praktikën e bazuara në të, jo më larg se deri më 1 dhjetor 2009;

III. Pas datës 1 dhjetor 2009, Gjykata vendos meritorisht për rastin si tërësi;

IV. Ky vendim i komunikohet palës kërkuese, palëve kundërshtare, RTK dhe KEK, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe publikohet në mënyrën duhur; dhe

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

24. Marrëveshja kontraktuese e lidhur ndërmjet KEK-ut dhe RTK-së, për arkëtimin e pagesës mujore, përfundoi më 30 nëntor 2009, dhe nuk është përtërirë më.
25. Pas dërgimit të vendimit për masa të përkohshme, Gjykata e shqyrtoi këtë çështje edhe më 14 qershor 2010 dhe vendosi për vazhdim të masës së përkohshme.
26. Vendimi për masa të përkohshme iu dërgua Kuvendit të Kosovës menjëherë pas nxjerrjes së tij. Si përgjigje ndaj rekomandimeve të Gjykatës për ta rishikuar nenin 20.1 të Ligjit për RTK-në dhe praktikën e bazuara në ato dispozita, Kuvendi iu përgjigj Gjykatës me një letër më 29 prill 2009.
27. Në letërën e 29 prillit 2009, dërguar Gjykatës, Kuvendi theksoi se më herët kishte ndërmarrë disa hapa lidhur me Ligjin për RTK-në, para se parashtruesi ta parashtronte kërkesën pranë Gjykatës. Kuvendi theksoi se më 16 shtator 2008, Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media i rekomandoi kryesisht së Kuvendit që ta miratonte nismën për ndryshime në Ligjin për RTK-në. Më 29 shtator 2009, Kryesia e Kuvendit e miratoi rekomandimin e Komisionit. Më 27 janar 2009, Komisioni mbajti një seancë publike. Më pas, Komisioni mbajti një seminar dyditor në të cilin morën pjesë përfaqësues të shumë institucioneve të interesuara.
28. Një grup punues e mbajti takimin e vet të parë më 8 shtator 2009 dhe përfshiu ekspertë që ndihmuan në hartimin e ndryshimeve të propozuara për këtë Ligj. Grupi punues shqyrtoi edhe ndryshime të tjera në takimin e mbajtur më 7 prill 2010. RTK ia dërgoi Komisionit propozimet për financimin e vet të ardhshëm më 20 prill 2010.

29. Është detyrë e Kuvendit të Kosovës ta sajorë një skemë që është transparente, e drejtë, e qëndrueshme, që përmban mbrojtje efikase dhe përkatëse për lirin e personave të varfër nga pagesa dhe që siguron synime të lavdërueshme për ofrimin e shërbimit të një transmetuesi publik të financuar në mënyrë adekuate.
30. Çështje edhe më me rëndësi, Kuvendi i Kosovës, në seancën plenare të mbajtur më 28 janar 2010, miratoi Vendimin Nr. 03'237 për financimin e përkohshëm të RTK-së prej 1 janarit 2010 deri më 30 qershor 2010.
31. Që nga ajo kohë, raporti vjetor i RTK-së për vitin 2010 thekson që në vitin 2010 10,464,000 euro e të ardhurave të saj të përgjithshme prej 12,305,162 eurove buronin nga buxheti shtetëror i Kosovës. Pjesa më e madhe e pjesës tjetër të të ardhurave të saj buronte nga reklamat. Kjo krahasohet me një shifër prej 7,080,276 eurove të pranuar nga abonimet publike prej të hyrave të përgjithshme prej 9,785,042 eurove në vitin 2009. Asnjë e ardhur nuk ishte marrë nga buxheti shtetëror i Kosovës në vitin 2009.
32. Gjykata vëren që, tani, asnjë tarifë nuk u ngarkohet apo arkëtohet drejtpërdrejt nga individët apo shtëpitë për ofrim të shërbimeve të RTK-së.

Pretendimet e parashtruesit

33. Parashtruesi pohon që Urdhëresa Administrative Nr. 2000/12 e shkel Kushtetutën e Republikës së Kosovës duke themeluar, që nga 1 marsi 2003, një marrëveshje kontraktuese përmes të cilës pagesa mujore për RTK-në në shumë prej 3.5 eurove imponohej dhe arkëtohej përmes faturave mujore të rrymës.
34. Urdhëresa Administrative Nr. 2003/12 u shpall nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara më 30 qershor 2003. Në nenin 2.1 dhe 4.1 të Urdhëresës thuhet me sa vijon:

Neni 2

Arkëtimi dhe pagimi i të hollave

2.1 Çdo shtëpi, biznes, ndërmarrje apo institucion tjetër në Kosovë është i obliguar sipas ligjit që ta paguajë këtë pagesë. Sipas kësaj Urdhërese administrative, shtëpi llogaritet një bashkësi familjare e cila i menaxhon punët e saj ekonomike si një entitet. Dëshmia për një menaxhim të tillë do të përfshijë një faturë unike të rrymës apo të shërbimeve telefonike.

Neni 4

Caktimi i lartësisë së pagesës

4.1 Lartësia e pagesës fillimisht do të jetë tre euro e gjysmë (3.5 €) në muaj dhe do të hyjë në veprim që nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Urdhërese administrative. Pagesa mbetet në fuqi derisa të caktohet një shkallë tjetër nga Kuvendi, në pajtim me nenin e 4.2 të mëposhtëm. Kjo pagesë përjashtohet nga të gjitha taksat dhe detyrimet.

35. Parashtruesi pohon që marrëveshja e KEK-ut, përmes të cilës konsumatori bëhet palë e obliguar që të paguajë kundër vullnetit të vet dhe pa lejen e tij dhe pa e nënshkruar kontratën për të bërë një gjë të tillë, përbën shkelje të *jus cogens* në lidhje me nenin 26 dhe 28 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.
36. Sipas parashtruesit, në bazë të nenit 103 dhe 51 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, detyrimet kontraktuese mund të zbatohen vetëm nëse imponohen në mënyrë të ligjshme. Ai pohon që kontrata është tërësisht e pazbatueshme mbi bazën se një konsumator bëhet

palë e obliguar kontraktuese pa pëlqimin e tij, duke u bërë palë “e paautorizuar” kontraktuese.

37. Parashtruesi konsideron që konsumatori është palë “e paautorizuar” në marrëveshjen për arkëtim dhe është i mashtruar. KEK-u, pa pëlqimin, lejen, marrëveshjen apo nënshkrimin e konsumatorit ka ndërmarrë masa pa e përfillur autoritetin e mirëfilltë ligjor. Ai thotë se zbatimi i kontratës në favor të RTK-së ishte bërë me dhunë dhe se, sipas parashtruesit, veprimet e KEK-ut lidhur me këtë kontratë nuk janë të vlefshme për qëllime të zbatimit të saj. Kontrata mund të bëhet e vlefshme vetëm për përfitim të RTK-së me vullnetin e lirë të dy palëve kontraktuese.
38. Parashtruesi pohon që marrja e vendimit për zbatimin e nenit 2.1 të Urdhërësës Administrative Nr. 2003/12 lidhur me pagesën mujore prej 3.5 eurove, të imponuar për çdo konsumator që ka kontratë me KEK-un, nuk është në pajtim me Kushtetutën e Kosovës.
39. Parashtruesi pohon që dështimi për t'i gjykuar të drejtat e tij përmes mënyrave gjyqësore përbën shkelje të të drejtave të tij personale, posaçërisht të atyre të drejtave të parapara me nenet 6, 13, 22 dhe 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të gjitha këto të drejta garantohen me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Statusi i viktimës

40. Në mënyrë që parashtruesi individual të jetë i suksesshëm në një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duhet që ai ose ajo të jetë në gjendje të përcaktojë që është viktimë e shkeljes nga një autoritet publik. Gjykata e theksoi këtë koncept kur mori vendim për caktim të masave të përkohshme më 16 tetor 2009 në këtë mënyrë: *“Në lidhje me këtë, praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut thotë se pala mund të kërkojë masa të tilla dhe t'i lejohen nëse “... pala ka sjellë prova prima facie për ekzistimin e një praktike të tillë dhe që është viktimë e saj” (Krahaso Biriuk kundër Lituanisë, Nr. 23373/0325, paragrafi 27, 25 shkurt 2009, mutatis mutandis, Krahaso Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar, 22 tetor 1981, paragrafi 40-41, Seria A Nr. 45).”*
41. Pa marrë parasysh statusin që parashtruesi kishte në kohën e parashtrimin të kërkesës ose në kohën e lejimit të masave të përkohshme, ngjarjet kanë lëvizur që nga atëherë, gjë që tregojnë se pozita e parashtruesit ka ndryshuar dukshëm. Pozita aktuale është se as parashtruesi apo ndonjë shtëpi në Republikën e Kosovës nuk ngarkohet me pagesën mujore për ofrim të shërbimeve të RTK-së. Në dritën e kësaj, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse ka merita për të vazhduar tutje me këtë çështje dhe nëse parashtruesi ka status apo pozitë për ta arsyetuar statusin e tij si viktimë edhe më tej.
42. Gjykata ka kompetencë dhe e ka për detyrë ta shqyrtojë këtë çështje posaçërisht nga pikëpamja e Rregullores së punës së Gjykatës.
43. Rregulli 32 (4) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese thotë që Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme ose që nuk përfaqësojnë një rast ose kontest. Ky rregull, në pjesën përkatëse, thotë me sa vijon:

Rregulli 32

Tërheqja e kërkesës dhe përgjigjes

...(4) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme ose që nuk përfaqësojnë një rast ose kontest.

(5) Sekretariati njofton të gjitha palët me shkrim për çfarëdo tërheqje, për çfarëdo vendimi të Gjykatës për të vendosur në lidhje me kërkesën, pavarësisht tërheqjes së saj, dhe për çfarëdo vendimi për ta hedhur poshtë kërkesën para vendimit përfundimtar.

44. Gjykata Kushtetuese e Kosovës nuk është e vetmja që ka një rregull të tillë. Ky rregull pasqyron pothuaj praktikën universale në juridiksionet juridike në botë. Vërtet, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në pjesën përkatëse, thotë:

Neni 37. Çregjistrimi i kërkesave

1. Në çdo fazë të procedimit, Gjykata mund të vendosë të çregjistrojë një kërkesë, kur rrethanat çojnë në përfundimin se:

- a. Kërkuesi nuk ka ndërmend ta vazhdojë çështjen;*
- b. Çështja është zgjidhur; ose*
- c. Për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës.*

Megjithatë, Gjykata vazhdon shqyrtimin e kërkesës kur këtë e kërkon respektimi i të drejtave të njeriut të garantuara nga Konventa dhe protokollet e saj.

2. Gjykata mund të vendosë rifutjen e një kërkesë në listën e çështjeve kur konsideron se rrethanat e justifikojnë këtë.

45. Si rregull i përgjithshëm, Gjykata nuk duhet të marrë vendime në rastet në të cilat çështja më nuk është aktuale. Ky është një parim në përgjithësi i pranuar i sjelljes së gjykatave dhe është analog me parimin e kufizimit gjyqësor. Kuvendi, pas rekomandimit të Gjykatës në Vendimin origjinal për Masa të Përkohshme, i shkroi Gjykatës duke e informuar për hapat që ishin duke u ndërmarrë nga Kuvendi për ta trajtuar çështjen e financimit të shërbimit të transmetimit publik në Kosovë.
46. Koncepti i të qenët pa objekt shqyrtimi është koncept i mirënjohur ligjor. Mund të paraqitet në një rast kur një çështje abstrakte apo hipotetike paraqitet për t'u vendosur në Gjykatë. Ka baza të mira që një Gjykatë të mos merret me situata hipotetike. Pa një çështje të vërtetë, të menjëhershme apo konkrete për të cilën duhet të vendoset, Gjykata mund ta devijojë në marrjen e vendimeve që e obligojnë atë dhe publikun pa pasur arsye të mirë për të. Çfarëdo vendimi që Gjykata merr tani lidhur me këtë kërkesë nuk do të ketë efekt praktik, posaçërisht për shkak të ngjarjeve që kanë ndodhur që nga caktimi i masave të përkohshme më 16 tetor 2009. Për më tepër, burimet e pakta të Gjykatës duhet të shfrytëzohen për t'u marrë me çështjet dhe kërkesat që presin të zgjidhen dhe që ndikojnë drejtpërdrejt në palë dhe jo ato në të cilat çështja është tani hipotetike apo akademike.
47. Data e fundit efektive për përdorimin e kontratës KEK – RTK për arkëtimin e pagesës mujore ishte 30 nëntori 2009. Pas asaj date, më nuk ekzistonte asnjë mekanizëm që e obligonte KEK-un për ta arkëtuar atë pagesë dhe është realitet që faturat e rrymës në Kosovë sot lëshohen pa këtë tarifë. Në kohën e lejimit të masave të përkohshme nuk kishte shkallë të mjaftueshme të sigurisë lidhur me këtë çështje dhe mendohej se caktimi i masave të përkohshme, në mënyrën e përshkruar më sipër, ishte i nevojshëm për t'i mbrojtur interesat e parashtruesit. Për këtë arsye, më nuk ka nevojë për caktim të mëtejshëm të masave të përkohshme apo të përhershme.

48. Duke pasur parasysh ngjarjet që kanë ndodhur dhe të gjitha çështjet e tjera të përmendura më lart, Gjykata arrin në përfundim se parashtruesi tani nuk ka rast apo kontest të pazgjidhur lidhur me arkëtimin e pagesës mujore për RTK-në. Ai nuk e ka më statusin e viktimës lidhur me skemën për arkëtimin e pagesës mujore. Kjo çështje është pa objekt shqyrtimi. Për këtë, nuk është me vend të nxirret asnjë urdhër për masa të përkohshme apo të vazhdohet me shqyrtimin e mëtejme të kërkesës.

PËR KËTO ARSYE


Në përputhje me nenin 113(7) të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 32(4) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOS

- I. TA HEQË kërkesën nga lista në përputhje me rregullin 32.4 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja Raportuese

Iliriana Islami

The seal of the Constitutional Court of Kosovo is circular, featuring a central figure and text in Albanian and English. It is positioned between the two signatures.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani